



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:268931
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06204404

C-IV-13-3386

Parashtruesi i Kërkesës

F G nga Prishtina.

kundër

Pala kundërshtare

Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH “Amortizatorët” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 25 shtator 2024 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 nëntor 2013, pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj një kërkesë për rishikimin e Vendimit (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) PRN047-0169 datë 8 tetor 2013, lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (në tekstin e mëtutjeshëm AL) me anë të cilit, është refuzuar kërkesa e ankuesit mbi anulimin e ndarjes së mjeteve financiare të inkasuara nga pagesa e qirasë së ambienteve të NSH dhe si rrjedhojë kompensimin e shumës shtesë prej 5,784.61 (pesë shtatë tetë katër gjashtë një) Euro, ndaj NSH “Amortizatorët” (në likuidim).

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

AKP me 6 dhjetor 2017, parashtroj përgjigjen.

AKP propozoj që kërkesa për rishikim të refuzohet dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e shkresës së NSH – kryesuesit të Bordit të saj, drejtuar AKP,
- Kopja e Raportit për shpërndarjen e mjeteve të inkasuara nga qiraja, për punëtorët e NSH, e nënshkruar nga kryetari i komisionit, datë 4 nëntor 2010,
- Kopja e Vendimit, datë 5 prill 2011, mbi lejimin e pagesës së mjeteve të inkasuara në emër të qirasë, në emër të tatimeve, kontributeve pensionale dhe pagave të punëtorëve të NSH, lëshuar nga kryetari i Bordit menaxhues,
- Kopja e kundërshtimeve të shqyrtuara të punëtorëve të NSH, ndaj mjeteve të ndara,
- Kopja e shkresës, datë 21 shkurt 2011, drejtuar AKP nga ana e menaxhmentit të NSH,
- Kopja e Ekstraktit të Procesverbalit, datë 7 shkurt 2011, me rastin e shqyrtimit të gjithsejtë 140 kundërshtimeve të punëtorëve të NSH kundër Vendimit – Regjistrimit mbi shpërndarjen e mjeteve të inkasuara nga qiraja, të shqyrtuara nga anëtarët e komisionit të NSH (në tekstin në vijim EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT), dhe
- Kopja e Vendimit nr. 379/1 datë 23 dhjetor 2010.

Përgjigja e AKP është tentuar ti dorëzohet ankuesit në adresën e dhënë, por nga raporti i personit zyrtar të postës thuhet se adresa është e pasaktë.

Me 21 gusht 2024, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesin mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja e lartë cekur, nga ana e personit zyrtar të zyrës postare, është tentuar ti dorëzohet ankuesit në adresën e dhënë me 23 dhe 29 gusht 2024 por pa-sukses.

Nga arsyet e lartë cekura vërejtja mbi pagesën e taksës gjyqësore është postuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi ankuesi nuk ka paguar taksat gjyqësore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 21 gusht 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartë cekura nuk hyri në shqyrtim të çështjes, në merita të saj.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar